



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 28, DATË 22.04.2020

PËR  
ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË SHOQËRISË “3DS&AF  
ENTERTAINMENT” SH.P.K., LICENCUAR PËR SHËRBIMIN E PROGRAMIT  
AUDIOVIZIV “SYRI TV” NË QARQET FIER DHE KORÇË

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, neneve 60 dhe 61 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 5, datë 29.01.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv”, pas shqyrtimit të aplikimit nr. 894 prot., datë 10.03.2020 të shoqërisë “3DS&AF ENTERTAINMENT” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “Syri Tv” në qarkun Fier dhe Korçë,

VENDOSI:

1. Pranimin e aplikimit të shoqërisë “3DS&AF Entertainment” sh.p.k., duke vendosur zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “Syri Tv” në qarqet Fier dhe Korçë
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA